





KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	18.04.2025
NR/BR. 01	90`/25
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi 
NGA/OD/FROM	Kryetari i Komunës Agim Aliu 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim-Vendim për Miratimin e plotësim ndryshimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunes së Ferizajt dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Shtëpia Ime" Ferizaj me Nr. 60/23 me datën 21.12.2023, për dhënien në shfrytëzim të ngastrës me Nr.638-0, ZK Zaskok.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 25 paragrafi 2, pika 2.9, neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 dt. 28.06.2013 si dhe propozim vendimi për miratim të Memorandumin ndërmjet Këshillit Danez për Refugjatë dhe Komuna Ferizaj, Kryetari i Komunës i bën këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për Miratimin e plotësim ndryshimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunes së Ferizajt dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Shtëpia Ime" Ferizaj me Nr. 379/23 me datën 20.10.2023, për dhënien në shfrytëzim të ngastrës me Nr.638-0, ZK Zaskok.

A R S Y E T I M I

Qëllimi i Memorandumit të cekur më lartë është që thekson angazhimin dhe përkushtimin e shoqërisë dhe institucionëve ndaj mirëqenies së të mbijetuarëve të dhunës në familje, dhunës në baza gjinore, ky memorandum është shenjë e vullnetit të lirë për të dhënë në shfrytëzim objektin për strehimin dhe sigurinë e të mbijetuarëve të dhunës për Regjionin e Ferizajt.

Lidhur me memorandumun e cekur më lartë Komuna e Ferizaj jep në shfrytëzim ngastren kadastrale me nr.638-0, ZK Zaskok, për 10 vjet me mundësi vazhdimi, por në rastë se nuk realizohet ky projekt i paraparë në memorandum, Komuna ka të drejtën e shkëputjes së memorandumit.

Andaj kërkoi nga Kuvendi si i tillë të miratohet ky Propozim -Vendim.



Komuna e Ferizajt

**MARRËVESHJE PËR
NDARYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET KOMUNËS SË FERIZAJT DHE QENDRËS PËR MBROJTJEN E
GRAVE DHE FËMIJËVE "SHTËPIA IME - FERIZAJ" NR.PROT.01 Nr.379/23, DATË:
20.10.2023.**

Palët nënshkruese përfaqësohen nga:

1. Komuna e Ferizajt, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Agim Aliu.
2. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve - Shtëpia Ime - Ferizaj (QMGF - Shtëpia Ime) e përfaqësuar nga drejtorja ekzekutive znj. Sevdije Kasumi - Bunjaku.

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet neni 2 (Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit) i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe QMGF "Shtëpia ime" me nr. protokollit 01.Nr.379/23 e datës 20.10.2023 si në vijim:

Memorandumi i Mirëkuptimit për dhënien në shfrytëzim të parcelës nr. 638-0, ZK Zaskok, Komuna e Ferizajt, është dokumenti rëndësishëm që thekson angazhimin dhe përkushtimin e shoqërisë dhe institucioneve ndaj mirëqenies së të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Ky memorandum është shenjë e vullnetit të lirë për të dhënë në shfrytëzim objektin e lartëcekur për t'u përmirësuar mjedisi i përshatshëm për ofrimin e shërbimeve sociale - profesionale në strehimin dhe sigurinë e të mbijetuarave të dhunës për Regjionin e Ferizajt. Ky program arrihet falë kushteve që do të ofrohen përmes hapësirës së përshatshme, teknologjisë, infrastruktures dhe mjeteve tjera të nevojshme përcjellëse.



Komuna e Ferizajt

Neni 2

Ndryshohet dhe plotësohet neni 4 (Rolet dhe përgjegjësitë e palëve të Memorandumit të Mirëkuptimit) në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe QMGF "Shtëpia ime" me nr. protokollit 01.Nr.379/23 e datës 20.10.2023, në pjesën e obligimeve të Komunës së Ferizajt si në vijim:

Komuna e Ferizajt:

- Do të jap në shfrytëzim OJQ-së Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime - Ferizaj objektin i cili është i ndërtuar në parcelën nr. 638-0, ZK Zaskok, Komuna e Ferizajt.

Neni 3

Pikat tjera të Memorandumit bazë të Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe QMGF "Shtëpia ime" me nr. protokollit 01.Nr.379/23 e datës 20.10.2023, përveç atyre të përmendura në këtë marrëveshje për plotësim ndryshim të Memorandumit bazë mbeten në fuqi.


Neni 4

Hyrja në Fuqi


Marrëveshja për Plotësim - Ndryshimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet në ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Palët nënshkruese:

Për Komunën e Ferizajt


Z. Agim Aliu
Kryetar i Komunës

Për QMGF "Shtëpia Ime"


znj. Syrdije Kasumi Banjaku
Drejtoresh e Ekzekutive

Datë: 21 / 12 / 2023